*31.08.2026*

# AIDA
# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2026

| **Nr. Rendor**[1] | **Data e kërkesës**[2] | **Objekti i kërkesës**[3] | **Data e përgjigjes**[4] | **Përgjigje**[5] | **Mënyra e përfundimit të kërkesës**[6] | **Tarifa**[7] |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **01** | 12.01.2026 | Më 25 qershor 2025, përmes shkresës me Nr. Prot 1385/1, Drejtoria e Investimeve Strategjike pranë AIDA-s, na ka thënë se Komiteti i Investimeve Strategjike ka ngritur prej datës 10 janar 2025 grupin e negocimit të marrëveshjes [...] në përgjigje thuhej se | 15.01.2026 | Referuar kërkesës suaj për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumenteve / informacioneve zyrtare në lidhje me propozimin për të investuar në [redacted] pasi pretendohet se ka spekulime se drejtuesi i kësaj kompanie është tërhequr ngainvestimi, ju informojmë si më poshtë vijon:<br>Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) po ndjek me prioritet procesin e negociatave me qëllim finalizimin e Projektit tëInvestimit [redacted] të miratuar nga Komiteti i Investimeve Strategjike, duke zhvilluar takime të vazhdueshme mepërfaqësues të institucioneve respektive që janë pjesë e Grupit të Negocimit, dhe nuk kemi asnjë njoftim të | E plotë | Nuk ka |

[1] Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve
[2] Data e regjistrimit të kërkesës
[3] Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[4] Data e kthimit të përgjigjes
[5] Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[6] Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar
[7] Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | "aktualisht grupi është në proces negocimi". Nisur nga fakti se ka kaluar rreth një vit nga nisja e këtyre negocimeve dhe spekulimeve se drejtuesi i kompanisë [redacted] është tërhequr nga investimi do të donim të kishim informacione zyrtare për pyetjet sa më poshtë:<br>1. Cili është statusi aktual i procesit të negocimit me [redacted] në janar 2026?<br>2. A ka pasur njoftim zyrtar për tërheqje nga kompania [redacted]? Nëse po, në cilën datë, në çfarë forme dhe çfarë arsyetimi?<br>3. A është mbyllur, pezulluar apo vazhdon ende | | [redacted] për tërheqje ngainvestimi, siç pretendohet. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | procesi i negocimit i nisur në janar 2025?<br>4. A ka pasur mbledhje të grupit negociator pas qershorit 2025? Sa mbledhje janë zhvilluar dhe kur?<br>5. A ka pasur interesime të tjera për zhvillime dhe investime në [redacted] për shembull nga kompani dhe investitorë shqiptarë? Nëse po, cili është statusi i këtyre interesimeve?<br>6. A është përgatitur ndonjë raport përfundimtar ose ndërmjetës mbi ecurinë apo dështimin e negociatave për projektin e investimeve në [redacted] | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **2.** | 26.01.2026 | Në vijim të përgjigjes suaj të 15 janar 2026, keni informuar se *AIDA po ndjek me prioritet procesin e negociatave për projektin* [redacted] *duke zhvilluar takime të vazhdueshme me përfaqësues të institucioneve respektive që janë pjesë e Grupit të Negocimit*, dhe duke marrë shkas nga përgjigjet e marra nga Ministria e Mjedisit, Ministria e Turizmit Kulturës dhe Sportit, si dhe Korporata e Investimeve Shqiptare, të cilat na adresojnë te ju për informacion, paraqesim këtë kërkesë në ushtrim | 05.02.2026 | Në vijim të kërkesës suaj të 4issi 26 janar 2026, me anë të së cilës kërkoni informacion mbi veprimtarinë e Grupit të Negocimit për projekt-propozimin [redacted] ju bëjmë me dije se ky 4ission po zhvillohet në përputhje të plotë me kuadrin ligjor për investimet strategjike. Referuar parashikimeve të 4issi 14 të Vendimit Nr. 23, datë 30.12.2024 të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS), si dhe Urdhrit të Kryetarit të KIS Nr. 6, datë 10.01.2025, është ngritur Grupi I Negocimit të Marrëveshjes (GNM) I cili ka në përbërje përfaqësues nga Korporata Shqiptare e Investimeve (AIC), Aparati I Zëvendëskryeministrit, Aparati I Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Aparati I Ministrisë së Financave, Aparati I Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, [redacted] si dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve.<br><br>Përbërja e këtij grupi është përcaktuar mbi baza institucionale për të garantuar që negociata të zhvillohet brenda kuadrit ligjor të investimeve strategjike dhe parashikimeve të VKIS Nr. 23, datë 30.12.2024. Lidhur me ecurinë e takimeve dhe logjistikën e tyre, ju informojmë se afati I dhënë në dispozicion të kësaj negociate ishte deri më datë 13 nëntor 2025, por me dakordësi të palëve, kërkesa për shtyrjen e këtij afati është përcjellë për vendimmarrje nga Sekretariati Teknik në KIS. Aktualisht pritet zbardhja e | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | të së drejtës së garantuar nga ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".<br>Duke qenë se AIDA vepron në cilësinë e Sekretariatit Teknik të Komitetit të Investimeve Strategjike, kërkojmë informacion faktik dhe të dokumentuar mbi aktivitetin e zhvilluar deri më sot.<br>Konkretisht, kërkojmë:<br>1. Listën zyrtare me emra të anëtarëve të Grupit të Negocimit, sipas aktit të ngritjes së tij, përfshirë institucionin që përfaqëson secili.<br>2. Listën e mbledhjeve/takimeve zyrtare të | | vendimit dhe publikimi I detajeve të mëtejshme, pasi siç ju është bërë me dije edhe më 5iss, ky është një 5ission 5ission5l5tes5, vendimmarrjet mbi të cilin zbardhen nëpërmjet akteve zyrtare që bëhen publike dhe janë të aksesueshme nga kushdo pas përfundimit të fazave përkatëse.<br><br>Sa I përket pretendimeve për përfshirjen e zonave të tjera, sqarojmë se procesi I ndjekur sipas legjislacionit të investimeve strategjike përfshin vetëm projektin për të cilin është aplikuar zyrtarisht dhe jo projekte të tjera. Çdo detaj mbi përfaqësimin e 5issi propozuese apo elementet e bashkëpunimit local, administrohen në kuadër të dokumentacionit zyrtar të negociatave, I cili mbetet pjesë e dosjes administrative deri në zyrtarizimin e plotë të marrëveshjes. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, mbetet e angazhuar për të garantuar transparencën e procesit në përputhje me afatet dhe procedurat ligjore në fuqi. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | zhvilluara nga Grupi I Negocimit për projekt-propozimin nga data 10 janar 2025 deri më 23 janar 2026, me: a. datën e secilit takim;<br>b. kush kanë qenë institucionet pjesëmarrëse;<br>c. kush kanë qenë përfaqësuesit e 6issi propozuese [redacted]<br><br>3. A ka [redacted] një sipërmarrës, kompani apo përfaqësues lokal të përfshirë në procesin | | | | |
| **3.** | 30.01.2026 | Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", kërkojmë të na vini në dispozicion kopje të | 02.02.2026 | Në vijim të email-it tuaj lidhur me një kërkesë për informacion dhe sqarim mbi projekte të mundshme investimi turistik në zonën e Zvërnecit, ju informojmë se pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) nuk rezulton të jetë paraqitur asnjë shprehje interesi, kërkesëpër informacion, aplikim apo | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dokumentacionit zyrtar dhe informacionin mbi statusin (miratuar/pezullua r/refuzuar/në shqyrtim) të dosjeve të trajtuara në mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) / Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit (KKTU), 7issi poshtë:<br>• A ka AIDA në regjistrat/dokumen tacionin e saj shprehje interesi, kërkesa informacioni, aplikime, propozime investimi apo komunikime të tjera që lidhen me zhvillime turistike në Zvërnec (Vlorë)?<br>• A ka ndonjë nga këto procese/dosje që lidhet | | 7ission ndërmjetësimi nga asnjë investitor vendas apo I huaj për këtë 7iss.<br><br>Gjithashtu, sqarojmë se pranë AIDA-s nuk ekziston asnjë dosje, 7ission7l apo komunikim I çfarëdo natyre që të lidhet drejtpërdrejt osetërthorazi me znj. Ivanka Trump, përfaqësues të saj, apo kompani/partnerë të mundshëm të lidhur me të, në lidhje me investime në zonën eZvërnecit.<br><br>Sa I përket kërkesës suaj për informacion mbi dosjet e trajtuara në mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) / Këshillit Kombëtar tëTerritorit dhe Ujit (KKTU), ju sqarojmë se ky informacion nuk bën pjesë në kompetencat e AIDA-s. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | drejtpërdrejt ose tërthorazi [redacted] përfaqësuesit e saj, kompani të lidhura me të, ose partnerë biznesi?<br>• Nëse po, cilat janë subjektet/kompanitë e përfshira (emër I plotë, NUIS/selia kur është e mundur) dhe cili është objekti I interesit (resort, hoteleri, 8ission8l turistike, 8ission8l8tes8 mbështetëse, etj.)?<br>• Në çfarë faze ndodhen këto procese: kërkesë fillestare/shprehje interesi, shqyrtim nga AIDA, përgatitje dokumentacioni, përcjellje te institucione të tjera, aplikim për status "investitor strategjik", | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | vendimmarrje, etj.?<br>• A ka AIDA rol në lehtësimin/ndërmjetësimin institucional për këto nisma? Nëse po, cilat institucione janë kontaktuar ose përfshirë (p.sh. ministritë, Bashkia Vlorë, AKPT, AKB, AKZM, etj.)?<br>• A ka pasur takime zyrtare (me procesverbal/shkresë) midis AIDA-s dhe përfaqësuesve të investitorëve të lidhur me këto nisma për Zvërnecin? Nëse po, kur dhe për çfarë?<br>• A disponon AIDA dokumente shoqëruese (memo, shkresa hyrëse/dalëse, përmbledhje | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | projekti, prezantime) që mund të bëhen publike? Nëse ka kufizime (10issio tregtar/të dhëna personale), a mund të jepet version I redaktuar ose të paktën përshkrimi bazë I projektit dhe statusi I tij? | | | | |
| **4.** | 03.02.2026 | Projekti [redacted], projektuar nga [redacted], në zonën e Rrjollit, I cili ka marrë lejen e ndërtimit më datë 17/12/2024, a ka marrë statusin e "investimit strategjik"? Nëse po, ju lutem më kaloni dokumentacionin I cili e provon këtë vendimmarrje!<br><br>https://azht.gov.al/wp-content/uploads/2026/01/HARTA-E- | 06.02.2026 | Në përgjigje të kërkesës suaj lidhur me projektin [redacted] në zonën e Rrjollit, ju bëjmë me dije se për këtë projekt nuk rezulton asnjë vendim I Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS). | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | PLANVENDOSJES-VENDIM-NR-39-DATE-17.12.2024.pdf?fbclid=IwY2xjawPu1pxleHRuA2FlbQIxMABicmlkETFpcEpiVFF1WUd6RXhTSkRWc3J0YwZhcHBfaWQQMjIyMDM5MTc4ODIwMDg5MgABHiN2jyY_nBkhEONSIv3nRBnVOUlVUc0eUgRFgmJ_HhYe1a2_9YdDMAzOFdhA_aem_iaXHZrnZibp4Os-WyIrY3Q | | | | |
| **5.** | 10.02.2026 | Në vijim të komunikimit të mëparshëm mbi projekt-propozimin [redacted] Erblin Vukaj dhe redaksia e Citizens.al kërkojnë vënien në dispozicion të | 13.02.2026 | Në vijim të kërkesës suaj të datës10.02.2026 , po ju përcjellim informacionin e kërkuar lidhur me ecurinë e projektit [redacted]<br><br>Bashkëlidhur këtij komunikimi, gjeni kopje të Vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike (VKIS) [redacted] Ju bëjmë me dije se ky është I njëjti akt që gjendet I publikuar dhe I aksesueshëmpër publikun në faqen zyrtare të AIDA-s. Gjithashtu, | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dokumenteve administrative konkrete që lidhen me ngritjen dhe funksionimin e Grupit të Negocimit të Marrëveshjes. | | bashkëlidhur gjeni edhe Urdhrin për ngritjen e Grupittë Negocimit të Marrëveshjes (GNM).<br><br>Sa I takon dokumentacionit mbi argumentimin e nevojës për shtyrjen e afatit të negociatave (përtej dates 13 nëntor 2025), ju informojmë se mund ta aksesoni në faqen e website të AIDA pasi të behet 12issio. Ky akt do të bëjë transparent arsyetimin dhe afatet e reja zyrtare.<br><br>Lidhur me pyetjet e tjera që lidhen me detajet e negociatave, të drejtat e përdorimit të territorit apoprocedurat specifike ndërinstitucionale, ju bëjmë me dije se këto janë çështje që I përkasin fazësnegociuese. Ato do të bëhen publike në momentin që do të ketë një dakordësi finale mes palëve, e cila duhet t'u nënshtrohet paraprakisht të gjithë filtrave të vendimmarrjes përmes proceseve dhe akteve kupubliku gëzon akses të plotë ligjor. | | |
| **6.** | 12.02.2026 | A është paraqitur pranë AIDA-s ndonjë aplikim për statusin "investim strategjik" për një projekt turistik në zonën e sipërcituar në Rrjoll, Njësia Administrative Velipojë, Bashkia Shkodër? Nëse po, ju lutem na vini në | 18.02.2026 | Në vijim të kërkesës suaj për informacion, datë 12.02.2026, lidhur me një projekt turistik në zonën eRrjollit, Bashkia Shkodër, ju bëjmë me dije se pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ka pasur interest të shprehur për zhvillimin e kësaj zone, por ju sqarojmë se deri në këtë momentnuk rezulton të ketë asnjë vendimmarrje nga Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS). | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dispozicion informacion mbi:<br>o subjektin aplikues<br>o datën e aplikimit<br>o statusin aktual të aplikimit.<br>2. A është miratuar ndonjë vendim nga Komiteti I Investimeve Strategjike për këtë projekt? Nëse po, ju lutem na vini në dispozicion kopje të vendimit.<br>3. Ju lutem na vini në dispozicion përshkrimin zyrtar të projektit, nëse ekziston, përfshirë:<br>o sipërfaqen e parashikuar<br>o hartën e territorit të projektit<br>o vlerën e investimit<br>o subjektin investitor.<br>4. Çfarë dokumentesh mbi pronësinë e tokës ka paraqitur | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | subjekti aplikues në kuadër të këtij projekti?<br>5. Cili është statusi aktual I 14ission14l14 për këtë projekt (në shqyrtim, miratuar, refuzuar, pezulluar, etj.) | | | | |
| **7.** | 13.02.2026 | Më poshtë po ju përcjellim një kërkesë për informacion lidhur me statusin e zbatimit, fazat dhe progresin e projektit "Durrës Yachts & Marina", në përputhje me kompetencat e institucionit tuaj. | 26.02.2026 | Në vijim të kërkesës suaj, ju informojmë se projekti "Durrës Yachts & Marina", në kuadër të legjislacionitpër investimet strategjike, AIDA ndjek zbatimin e planit të veprimit të vendimit të KIS, që ndiqet ngainsitucionet e, pasi për cdo vendim të KIS, që të bëhet i ekzekutueshëm, duhet të ndiqenprocedura të mëtejshme dhe miratime kriteresh nga institucionet përgjegjëse sipas legjislacionit deri në aprovimin e aktit/eve të nevojshme administrative.<br><br>Në këtë kontekst për këtë projekt rezulton të ketë:<br><br>• Vendimi I KIS nr. 14/6 datë 2.12.2021;<br>• VKM nr. 861, datë 29.12.2021;<br>• Vendimi I KIS nr. 14/45, datë 18.7.2022;<br>• VKM nr. 494, datë 21.7.2022;<br>• Vendimi I KIS nr. 14/61, datë 27.10.2022;<br>• Ligj nr. 79/2022, datë 24.11.2022; | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | • VKM nr. 115, datë 1.3.2023.<br><br>Aktualisht, subjekti po vijon zbatimin e tij sipas etapave të parashikuara. Aktualisht, Faza e Parë e projektit ka hyrë në faze aktive zbatimi, ku punimet në terren dhe lançimi I njësive po ecin sipas planifikimit. Ky 15ission po kryhet në mënyrë graduale dhe të strukturuar, duke ndjekur afatet kohore të përcaktuara për të siguruar një mison të qëndrueshëm deri në finalizimin e plotë të kësaj faze. | | |
| **8.** | 25.02.2025 | Dokumentacion administrativ lidhur me statusin e investimit strategjik të projektit turistik "[redacted] zhvilluar në zonën Gjiri i Manastirit, Bashkia Sarandë | 26.02.2025 | Në kuadër të legjislacionit për investimet strategjike, AIDA ndjek zbatimin e planit të veprimit tëvendimit të KIS, që ndiqet nga insitucionet, pasi për cdo vendim të KIS, që të bëhet I ekzekutueshëm, duhet të ndiqen procedura të mëtejshme dhe komunikime/ miratime kriteresh nga institucionet përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi deri në aprovimin e aktit/eve të nevojshme administrative.<br><br>Në këtë kontekst për këtë projekt rezulton të ketë:<br><br>• Vendim KIS Nr. 8/6, datë 02.12.2021;<br>• Vendim të KKT Nr. 28, datë 28.12.2020, "[redacted]<br>• Vendim Nr. 9, datë 10.06.2021 "Për miratimin e lejes së ndërtimit për | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | objektin "ResortTuristik 2, 3 dhe 4 me parkime nëntokë" me vendndodhje në Bashkinë Sarandë";<br>• Vendim Nr. 26, datë 09.07.2024 "Për rishikimin e kushteve të lejes së ndërtimit përobjektin "Resort Turistik 2, 3 dhe 4 me parkime nëntokë" me vendndodhje në BashkinëSarandë".<br><br>Sa I përket përputhshmërisë me kriteret e legjislacionit të investimeve strategjike, AIDA bën 16issio kimeperiodike të dokumentacionit ligjor për projektet të cilat janë brenda afatit të statusit strategjik dhe/osekanë një kontratë afatgjatë me autoritetin kompetent pavarësisht afatit të statusit strategjik.<br><br>Sa I përket rastit në fjalë, projekti zhvillohet në 16issi private dhe është I pajisur me aktet e nevojshmeadministrative për zhvillim/ndërtim sipas kritereve ligjore të legjislacionit për zhvillimin e territorit, tëcilat vlerësohen nga institucionet kompetente.<br><br>Aktualisht, ju bëjmë me dije se afati I statusit strategjik të këtij projekti ka përfunduar. | | |
| **9.** | 26.02.2026 | **Kërkesë e deleguar nga Ministria e Financave**<br><br>A ka hartuar Ministria e | 05.03.2026 | Për sa i takon kërkesës suaj ju bëjmë me dije se organi kompetent është ministria përgjegjëse për financat.<br><br>Për sa i takon dy pikave të tjera të kërkesës tuaj ju informojmë se në kuadër të legjislacionit për investimet strategjike, AIDA ndjek zbatimin e | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Financave një analizë fiskale ose ekonomike për projektin "[redacted] Nëse po, kërkojmë një kopje të saj.<br><br>Cilat janë angazhimet financiare të shtetit shqiptar në këtë projekt, sipas dokumenteve zyrtare në fuqi?<br>A ekziston një dokument zyrtar që përcakton strukturën financiare të projektit? Nëse po, kërkojmë një kopje të tij | | planit të veprimit të vendimit të KIS, që ndiqet nga insitucionet e përgjegjëse, pasi për cdo vendim të KIS, që të bëhet i ekzekutueshëm, duhet të ndiqen procedura të mëtejshme dhe verifikime/miratime kriteresh nga institucionet përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi deri në aprovimin e aktit/eve të nevojshme administrative.<br><br>Për projektin në fjalë forma e bashkëpunimit, struktura e financimit etj. I gjeni në vendimin e KIS Nr. 14/61 date 27.10.2022, si propozimin për Këshillin e Ministrave. Në vijim Këshilli Ministrave ka proceduar me miratimin e akteve të cilat jua kemi përcjellë me email dhe më herët. Këto akte mund t'I gjeni të publikuara në hapësirën respektive të botimeve zyrtare (QBZ).<br><br>Për lehtësinë tuaj më poshtë dhe njëherë lista e akteve të miratuara dhe linku ku të aksesoni vendimet e KIS.<br><br>• Vendimi I KIS nr. 14/6 datë 2.12.2021;<br>• VKM nr. 861, datë 29.12.2021;<br>• Vendimi I KIS nr. 14/45, datë 18.7.2022;<br>• VKM nr. 494, datë 21.7.2022;<br>• Vendimi I KIS nr. 14/61, datë 27.10.2022;<br>• Ligj nr. 79/2022, datë 24.11.2022;<br>• VKM nr. 115, datë 1.3.2023. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | https://aida.gov.al/investimet-ne-shqiperi/strategjike/komiteti-investimeve-strategjike-kis/ | | |
| **10.** | 17.03.2026 | 1. Listën e kompanive që kanë shprehur interes për investim në TEDA, së bashku me datat dhe dokumentacionin e depozituar.<br><br>2. Lista e kompanive që kanë nënshkruar kontrata apo marrëveshje konkrete, së bashku me kopjet e dokumenteve.<br><br>3. Afatet e sakta të zbatimit të projektit (fillimi dhe përfundimi sipas kontratave).<br><br>4. Dokumentet zyrtare që tregojnë fazën aktuale të punimeve në terren (lejet e ndërtimit, kontratat | 24.03.2026 | Në vijim të kërkesës suaj për informim lidhur me ecurinë e projektit të Zonës së Zhvillimit Ekonomik dhe Teknologjik (TEDA) në Tiranë, ju informojmë se Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), nëpërputhje me kuadrin ligjor të investimeve strategjike në fuqi, ka si mision kryesor ndjekjen e zbatimit tëvendimeve të marra nga Komiteti I Investimeve Strategjike (KIS) dhe përmbushjen e detyrave specifike që rrjedhin prej tyre. Në këtë kuadër, roli i AIDA kufizohet vetëm në monitorimin e Planit të Veprimit tëpërcaktuar në vendimin e KIS.<br><br>Për sa i përket pikave specifi ke të kërkesës suaj, të cilat lidhen me listat e kompanive të interesuara, dokumentacionin e depozituar, kopjet e kontratave apo marrëveshjeve konkrete, si dhe detajet të tjera teknike, ju bëjmë me dije se AIDA nuk është institucioni që administron apo disponon këtë dokumentacion. Këto të dhëna operacionale dhe teknike, i përkasin drejtpërdrejt entit menaxhues, që është subjekti TEDA Tirana shpk. Kjo shoqëri është themeluar posaçërisht nga Bashkia Tiranë për administrimin, menaxhimin dhe zhvillimin e Zonës Teknologjike dhe Zhvillimit Ekonomik, dhe | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | me ndërtues, aktet e fillimit të punimeve).<br><br>5. Kopje të Raporteve të monitorimit të projektit mbi progresin e punimeve dhe zbatimit.<br><br>6. Statusin e marrëveshjes me kompaninë H.A.P.I Advanced Technologies LTD, duke përfshirë kopjet e kontratës apo marrëveshjes me TEDA/AIDA | | është autoriteti kompetent që zotëron informacionin e plotë.<br><br>Për këtë arsye, ju sugjerojmë që për marrjen e informacionit të kërkuar t'i drejtoheni subjektit TEDA Tirana sh.p.k. | | |
| | | Kopje të:<br>a) Vlerësimi paraprak i potencialit strategjik<br>b) Vlerësimi Teknik, Financiar dhe Ligjor i dosjes, të cilat hartohen nga Grupi Operacional dhe | | Referuar kërkesës tuaj ju sqarojmë si më poshtë vijon: Procedura që ndiqet për investimet strategjike bazohet në një legjislacion të posaçëm, përkatësisht:<br>• Ligj nr. 55/2015, "Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë", I ndryshuar, dhe<br>• VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015;<br>• VKM Nr. 1024, datë 16.12.2015;<br>• VKM Nr. 1025, datë 16.12.2015;<br>• VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **11.** | 31.03.2026 | Sekretariati Teknik i KIS (përmes Agjencisë Shqiptare të Investimeve)<br>c) Vlerësimi i KIS për “elementin strategjik”; që i kanë paraprirë vendimeve të mëposhtme:<br>1. Vendim NR. 8, datë 15.07.2025;<br>2. Vendimin nr. 1, datë 10.04.2025<br>3. Vendimin Nr. 25/2, datë 20.11.2017,<br>4. Vendimin Nr. 25/5, datë 15.12.2020<br>5. Vendimin Nr. 25/15, datë 06.06.2023 | 14.04.2026 | • VKM Nr. 1027, datë 16.12.2015;<br>• VKM Nr. 1028, datë 16.12.2015;<br>• VKM Nr. 1029, datë 16.12.2015;<br>• VKM Nr. 1030, datë 16.12.2015;<br>• VKM Nr. 1031, datë 16.12.2015;<br>• VKM Nr.1032, datë 16.12.2015.<br>Në bazë dhe zbatim të këtij legjislacioni të posacëm, AIDA ka tre misione:<br>• Dritare Unike për investitorët dhe projektet;<br>• Sekretariat Teknik i Komitetit të Investimeve Strategjike;<br>• Agjent Asistues i subjektit dhe/ose projektit që ka përfituar status strategjik.<br><br>Në këtë kuadër, ju bëjmë me dije se vlerësimet e kryera nga Sekretariati Teknik dhe Grupi Operacional janë dokumente përgatitore, të cilat shërbejnë ekskluzivisht për marrjen e vendimmarrjes nga Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS), si organi i vetëm vendimmarrës i ngarkuar nga ligji. Për rrjedhojë, i gjithë procesi i vlerësimit të kritereve dhe analizës së elementit strategjik pasqyrohet dhe përmblidhet në Vendimin e KIS, i cili është dokumenti zyrtar që konfirmon përputhshmërinë e projekteve me kërkesat e legjislacionit të sipërcituar. AIDA, në cilësinë e Sekretariatit Teknik, administron procedurën por nuk disponon autorizimin për të shpërndarë dokumentacionin e brendshëm vlerësues apo të dhënat konfidenciale, jashtë parashikimeve të ligjit të posaçëm.” Vendimet e KIS janë të | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | zbardhura dhe firmosura nga anëtarët e KIS, së bashku me planet e miratuar të veprimit për këto projekte. Vendimet në fjalë trajtojnë në mënyrë të qartë procedurën e ndjekur dhe dispozitat ligjore në fuqi në të cilat është bazuar procedura e ndjekur. Lidhur me këto të fundit, një nga kopjet origjinale të tyre administrohet pranë AIDA. Zbardhja evendimeve të cilat aksesohen lehtësisht në hapësirën respektive të webit të AIDA, bazohet rreptësisht nëvendimin zyrtar. Duke qenë se në web mungojnë anekset shoqëruese të vendimeve (në rastin kur e kanënjë të tillë), lutem gjeni bashkëlidhur kopje të vendimeve të lartpërmendura së bashku me anekset respektive. | | |
| **12.** | 07.04.2026 | Ju lutem na vendosni ne dispozicion:<br>-Nga viti 2016 e deri më tani sa projekte për investime strategjike janë trajtuar, sa kanë përfituar statusin, sa janë në fazë vlerësimi dhe sa janë refuzuar?<br>-Sa është numri i përfituesve që janë investitorë të huaj, sa janë vendas dhe | 09.04.2026 | Në vijim të kërkesës suaj lutem gjeni bashkëlidhur informacion mbi projektet e miratuara dhe të mospranuara nga KIS, për periudhën 2016- 2025. Per lehtësine tuaj në link më poshtë mund të gjeni të publikuar ne webin e AIDA, të gjitha vendimet e KIS. https://aida.gov.al/investimet-ne-shqiperi/strategjike/komiteti-investimeve-strategjike-kis/<br>Lidhur me projektet në faze asistimi, ju informojmë se përgjatë vitit 2025 dhe 3 mujorit te pare te vitit 2026, AIDA ka asistuar në fazë paraprake 37 (tridhjete e shtatë) projekte në total. Çdo subjekt aplikues, mbahet i informuar sistematikisht nga stafii AIDA lidhur me kërkesën e tij, duke u asistuar mbi procedurat e aplikimit dhe dokumentacionin përkatës që duhet të dorëzohet. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | sa janë të përbashkët?<br>-Në çfarë fushash kanë qenë kryesisht projektet e miratuara? | | | | |
| **13.** | 18.05.2026 | Në mbështetje të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe në cilësinë e personit me interesa pronësore, trashëgimore dhe ekonomike mbi pasurinë nr. **1/511, ZK 1952, Livadh, Himarë**, kërkojmë nga AIDA informacion të plotë zyrtar dhe kopje të dokumentacionit që disponohet ose administrohet prej saj lidhur me çdo projekt investimi në zonën Livadh, Himarë.<br><br>Kjo kërkesë nuk kufizohet vetëm te | 29.05.2026 | Nga verifikime të kryera, nuk rezulton të ketë asnjë projekt të miratuar apo në fazë aplikimi me status "Investim/Investitor Strategjik" që të prekë, përfshijë, përmendë apo të ketë ndikim mbi pasurinë me Nr. 1/511, ZK 1952. Gjithashtu, ju konfirmojmë se në dokumentacionin e administruar nga AIDA nuk figuron asnjë kërkesë apo procedurë në emër të subjekteve apo personave të specifikuar në kërkesën tuaj, si [redacted]<br><br>Institucioni ynë mbetet i angazhuar për të garantuar transparencë të plotë dhe zyrtare për çdo informacion që administrohet pranë nesh. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | [redacted]. Kërkesa përfshin çdo person fizik ose juridik, çdo investitor, zhvillues, ortak, përfitues real, përfaqësues, kompani të lidhur, shoqëri projekti, konsorcium, subjekt aplikues ose çdo person tjetër që ka kërkuar, përfituar ose është përfshirë në procedura investimi strategjik, investimi turistik, investimi zhvillimor ose mbështetje institucionale në zonën Livadh, Himarë. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Qëllimi i kërkesës është të verifikohet nëse pasuria nr. **1/511, ZK 1952**, ose pasuri të tjera familjare të lidhura me trashëgimtarët e [redacted] janë përfshirë, prekur, përdorur, kufizuar ose paraqitur si pjesë funksionale, zonë ndihmëse, akses, rrugë hyrëse, parkim, infrastrukturë teknike, zonë shërbimi ose pjesë e ndonjë projekti investimi. | | | | |
| **14** | 04.06.2026 | Po ju drejtohem ne cilesine e koordinatorit per te drejten e informimit prane AIDA. Në bazë të Ligjit nr.119/2014, “Për të Drejtën e | 08.06.2026 | Në vijim të kërkesës tuaj, ju bëjmë me dije se Kompania "[redacted] e cila kashfaqur interes për ishullin e Sazanit, nuk ka depozituar ndonjë shkresë për tërheqje nga ky proces. Qëprej miratimit të statusit strategjik me procedurë të veçantë në dhjetor të vitit 2024, projekti ka hyrë nënjë cikël të gjatë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Informimit”, kërkoj të më vihet në dispozicion brenda afatit ligjorinformacioni i kërkuar në formularin bashkëngjitur. Ju lutem më informoni për marrjen e kërkesës. | | procedurash institucionale që rregullojnë bashkëpjesëmarrjen e shtetit në investime tëkësaj natyre. Për shkak të kompleksitetit ligjor dhe teknik të vetë zonës, afatet fillestare u rishikuan dhe ushtynë përmes një vendimi të dytë në dhjetor të vitit 2025. Aktualisht, i gjithë procesi ndodhet në fazëne vlerësimeve teknike dhe negociatave dypalëshe, ku secila palë ka afatet e veta për të dorëzuardokumentacionin e kërkuar. Për lehtësinë tuaj vendimet e KIS mund t'i aksesoni në link https://aida.gov.al/investimet-ne-shqiperi/strategjike/komiteti-investimeve-strategjike-kis/ | E plotë | Nuk ka |
| **15.** | 10.06.2026 | Jam [redacted] Me nevojiten informacionet sipas dokumentitbashkengjitur! | 16.06.2026 | Në vijim të kërkesës suaj, ju informojmë, si më poshtë vijon: Pyetjet tuaja 1,2,3 ezaurohen plotësisht nga informaconi i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare tëAIDA, respektivisht në link: https://aida.gov.al/investimet-ne-shqiperi/strategjike/komiteti-investimeve-strategjike-kis/ Këtu mund të gjeni të gjitha vendimmarrjet e Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS), përfshirë dhekërkesat e mos-pranuara për miratim statusi. Referuar nenit 18 të ligj 55/2015, i ndryshuar i ciliparashikon përmbajtjen e një vendimi të KIS, në vendimet e publikuara, do të gjeni gjithçka tënevojshme për analizën tuaj. Ndërkohë në | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | link:https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2026/06/Raporti-Vjetor-Aida-2026.pdf do të gjeni Raportin mëtë fundit të AIDA, atë të vitit 2025. Në çdo raportim 26roces të AIDA, në një seksion të vecantë zënë dheinvestimet strategjike. Për 26roc të 26roc, në Raportin Vjetor të vitit 2025 është përfshirë dhe monitorimi, si një funksion shtesë i detyrave të AIDA, rregulluar me ligj nr. 8/2025, datë 30.1.2025, i cili ndryshoi ligjnr. 55/2015. Lutem të kihet parasysh që monitorim, sipas këtij ligji, nënkuptohet një 26rocess që lidhetvetëm me monitorimin e Planit të Veprimit të vendimit të KIS (pra detyrat e lëna për institucionet aposubjektet, rast pas rasti), ndërsa monitorimi i zbatimit të kontratave dhe lejeve përkatëse është procesqë ndiqet drejtpërdrejt nga autoritetet përgjegjëse (ministritë e linjës ose institucionet e tjera publikesipas sektorëve) që kanë nënshkruar marrëveshjet apo që mbulojnë fushën e investimit.Gjithashtu, ju bëjmë me dije se në nenin 19 të Ligjit Nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në RSH”, indryshuar, parashikohen rrethanat e “Pezullimit të përkohshëm, anulimit dhe shfuqizimit të vendimit tëKomitetit të Investimeve Strategjike”. Deri më tani, pranë Sekretariatit Teknik të KIS (AIDA), nuk ka asnjërast të referuar nga autoritetet përgjegjëse | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | për monitorimin e projekteve ku të jetë konstatuar apovërtetuar ndodhja përpara kushteve të revokimit të parashikuara në këtë dispozitë ligjore. | | |
| **16.** | 10.06.2026 | Kërkese për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit zyrtar | 24.06.2026 | AIDA me shkresë zyrtare Nr. 1204/1 prot, datë 24.06.2026 ka kthyer përgjige duke ezauruar të gjitha pyetjet. | E plotë | Nuk ka |
| **17.** | 18.06.2026 | Në mbështetje të legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit, ju lutem të më vini në dispozicionlistën e plotë të projekteve që kanë marrë statusin e “Investimit Strategjik” ose “Investitorit Strategjik” në Republikën e Shqipërisë gjatë periudhës nga 1 janari 2020 deri në datën e përgjigjes suaj.<br><br>Nëse është e mundur, për secilin projekt do të | 18.06.2026 | Në vijim të kërkesës suaj, ju informojmë, si më poshtë vijon:<br><br>Kërkesa juaj ezaurohet plotësisht nga informaconi i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të AIDA, respektivisht në link:<br><br>https://aida.gov.al/investimet-ne-shqiperi/strategjike/komiteti-investimeve-strategjike-kis/<br><br>Këtu mund të gjeni të gjitha vendimmarrjet e Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS), përfshirë dhekërkesat e mos-pranuara për miratim statusi. Referuar nenit 18 të ligj 55/2015, i ndryshuar i ciliparashikon përmbajtjen e një vendimi të KIS, në vendimet e publikuara, do të gjeni gjithçka tënevojshme. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | vlerësoja të përfshiheshin të paktën këto të dhëna:<br><br>Emri i projektit;<br><br>Emri i investitorit / subjektit përfitues;<br><br>Sektori i investimit;<br><br>Vlera e investimit të miratuar;<br><br>Data e miratimit të statusit strategjik;<br><br>Vendimi përkatës i Komitetit të Investimeve Strategjike ose i organit kompetent;<br><br>Vendndodhja e projektit;<br><br>Statusi aktual i zbatimit të projektit. | | Ndërkohë në link:<br><br>https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2026/06/Raporti-Vjetor-Aida-2026.pdf<br><br>do të gjeni RaportinVjetor më të fundit të AIDA. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Gjithashtu, nëse dispononi një regjistër 29im ë29, raport vjetor ose dokument përmbledhës që përmbankëto të dhëna, ju lutem ma përcillni në format elektronik ose më informoni mbi mënyrën e aksesimit tëtij. | | | | |
